



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:163371

Datë: 04.06.2024

Numri i dokumentit: 05775325

A.C.nr.1140/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Bujar Muzaqi kryetar, Enes Mehmeti, dhe Hysni Bardheci, anëtar, në çështjen juridike – kontestimore të paditësit S.G. nga fshati ..., Komuna Lipjan, të cilin e përfaqëson me autorizim S.K., avokat me seli në Komuna Lipjan, kundër të paditurit R.I. nga Fushe Kosova, të cilin e përfaqëson me autorizim A.K., avokat me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të rimbursimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe të paditurës, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.504/2014 datë 15.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 22.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar ankesa e të paditurit R.I. nga Fushe Kosova, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.504/2014 datë 15.01.2021, dhe gjykohet si vijon: **REFUZOHET e pabazuar** kërkesëpadia e paditësit S.G. nga fshati ..., Komuna Lipjan, me të cilën ka kërkuar që të **DETYROHET** i padituri R.I. nga Fushë Kosova, qe paditësit në emër të shpërblimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të dt. 02.01.1997, në rrugën magjistrale Prishtinë-Peje në fshatin ... tek ura e lumit “Sitnica”, të ia paguaj shumat si vijon: 1. Dëmin jo material a) në emër të dhimbjeve fizike- trupore shumë prej 3.000,00.-€. b) në emër të frikës shumë prej 2.850,00.-€, c) në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 3.500,00.-€. 2. Dëmin material a) në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 300,00.-€. b) në emër të ndihmës, dhe përkujdesjes së personit të tretë shumë prej 300,00.-€. -të gjitha këto shuma, me kamatë vjetore sipas shkallës së kamatës që paguajnë bankat për mjete të deponuara në banke mbi një vit pa destinim të caktuar në tërësi, **E PABAZUAR**.

II. REFUZOHET e pathemeltë, ankesa e paditësit S.G. nga fshati ..., Komuna Lipjan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.504/2014 datë 15.01.2021, në pikën II, **VËRTETOHET**.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.504/2014 datë 15.01.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“... I. APROVOHET pjesërishtë kërkesëpadia e paditësit S.G. nga fshati ..., si e BAZUAR, OBLIGOHET i padituri R.I. nga Fushe Kosova, qe paditësit ne emër te shpërblimit te demit te shkaktuar ne aksidentin e komunikacionit rrugor te dt. 02.01.1997, ne rrugën magjistrale Prishtine-Peje ne fshatin ... tek ura e lumit “Sitnica”, te ia paguaj shumat si vijon:

1. Dëmin jo material

- a) në emër të dhimbjeve fizike- trupore shumën prej 3.000,00.-€.*
- b) ne emër te frikës shumen prej 2.850,00.-€*
- c) ne emër te zvogëlimit te aktivitetit te pergjitheshem jetësor shumen prej 3.500,00.-€*

2. Dëmin material

- a) në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 300,00.-€*
- b) në emër të ndihmës dhe përkujdesjes se personit te trete shumën prej 300,00.-€-të gjitha këto shuma, me kamatë vjetore sipas shkalles se kamatës qe paguajn bankat per mjete te deponuara ne banke mbi nje vit pa destinim te caktura duke filluar nga data 15.01.2021, e deri te pagesa definitive.*

II. Kërkesëpadia e paditësit për rehabilitim shëndetësor ne shume prej 1.200,00.-€ dhe per zvogëlim te aftësive punuese ne shume prej 900,00.-€, si dhe kërkesëpadia e paditësit më tepër se shumat e aprovuara, si ne al.1 te dispozitivit te keti aktgjykimi, REFUZOHEN si të pa bazuara.

III.OBLIGOHET pala e paditur, t'ia paguaj pales paditëse shumat nga pika I. e ketij aktgjykimi si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumën prej 1.472.60.-€, të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmëris së këti aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm...”

Kundër aktgjykimit C.nr.504/2014 datë 15.01.2021, ka parashtruar ankesë paditësi, për shkak të: shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit të ndryshohet aktgjykimi dhe t'ia paguaj paditësit për rehabilitim shëndetësor shumën prej 1200 €uro, si dhe shpenzime e procedurës 5.974.40 €uro, dhe në pjesë tjera aktgjykimi të vërtetohet.

Kundër aktgjykimit C.nr.504/2014 datë 15.01.2021, ka parashtruar ankesë i padituri për shkak të : shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurit.

Përgjigje në ankesa nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë në bazë të nenit 194 lidhur me nenin 208, të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore gjeti se:

-Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

-Ankesa e të paditurit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi S.G. nga fshati ..., Komuna Lipjan, ka paraqitur padi kundër të paditurit R.I. nga Fushe Kosova, me kërkesë për kompensimin e dëmit.

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin C.nr.153/2003 datë 01.10.2003, e ka hedhe kërkesëpadinë e paditësit.

Kundër këtij aktvendimi pala paditëse ka parashtruar ankesë.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktvendimin AC.nr.337/2004, e ka prishë aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë C.nr.153/2003 datë 01.10.2003, dhe e ka kthyer lëndën në rigjykim.

Në rigjykim, Gjykata e shkallës së parë, me Aktgjykimin C.nr.283/07 datë 28.10.2011, e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Kundër këtij aktgjykimi pala paditëse ka parashtruar ankesë.

Gjykata e Apelit të Kosovës me Aktvendimin CA.nr.2821/2012 datë 01.10.2014, e prishë Aktgjykimin Gjykatës së shkallës së parë C.nr.283/07 datë 28.10.2011, dhe e ka kthyer lëndën në rigjykim.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 15.01.2021, pas dëgjimit të palëve në rigjykim, dhe pas administrimit të provave, ka marrë aktgjykim C.nr.504/2014 datë 15.01.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, S.G., duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ndër të tjera ka arsyetuar se: *"... gjykata erdhi deri tek përfundimi se aksidenti në komunikacionin rrugor të dt. 02.01.1997, në rrugën magjistrale Prishtinë-Peje në fshatin ... të ura e lumit "Sitnica", është shkaktuar me lëshimet e ngasësit të automjetit "xxx" me targa të regjistrimit xxx R.I., me lëshimet e ngasësit të automjetit "xxx", me targa të regjistrimit*

xxx B.B. dhe me kontributin e faktorit rruge, per shkak te mosmirëmbajtjes se duhur te shtresës se asfaltuar te rrugës ne kushtet e dimirit dhe paraqitjes se akullit ne rruge...”.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit në pikën II, për arsye se aktgjykimi i atakuar në pikën II nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e shkallës së dytë vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket pikës I, dhe III të dispozitiviti të aktgjykimit të atakuar, për faktin se aktgjykimi i atakuar në pikën I, dhe III nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, të cilat gjykata e shkallës së dytë i vështron sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, mirëpo gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë, andaj Gjykata e shkallës së dytë duke u bazuar në shkresat e lëndës, ka vendos që aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet, dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet e pa bazuar e në bazë të nenit 195/1 nën pikën e), e lidhur me nenin 201 par.1 nën pikën d), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

Në bazë të shkresave të lëndës konstatohet se aksidenti i trafikut për të cilën shkak paditësi ka kërkuar kompensimin e dëmit ka ndodhur me datë 02.01.1997, ndërsa paditësi ka parashtruar padinë në gjykatë me datë 05.06.2003, që do të thotë se nga momenti i ndodhjes së aksidentit e deri në paraqitjen e padisë në gjykatë, kanë kaluar mbi 5 vite e që në nenin 371 par.1 të LMD-së në mënyrë decisive thuhet se *“Kërkesat parashkruhen për pesë vjet në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit”.*

Arsyetimi i Gjykatës së shkallës së parë në aktgjykimin e atakuar se afati i parashkrimit lidhet me parashkrimin e ndjekjes penale, dhe për vepër penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297.1 i Kodit të përkohshëm penal të Kosovës, nuk qëndron pasi që në shkresat e lëndës nuk ka prova se është filluar ndonjë procedurë penale në shkallën e parë lidhur me aksidentin e trafikut të ndodhur me datë 02.01.1997 në vendin e quajtur në Rrugën magjistrale Prishtinë - Pejë.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën III, të këtij dispozitivi që secila palë të i bartë shpenzimet e procedurës e duke u bazuar në nenin 450 të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore në mënyrë decisive thuhet se: *“Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta”.*

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi i atakuar në pikën II është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ngase sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pikën II është mjaft i kuartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për refuzimin e kërkesëpadisë në pikën II e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket pretendimit ankimor të palës paditëse se kemi të bëjmë me aplikim të gabuar të drejtës materiale nuk ka ndonjë pretendim konkret në të cilën është thirrur pala ankuese në ankesë, ndërsa nuk ka shkelje për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditësit mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë përmendurat u vendos sikurse në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e), e lidhur me nenin 201 par.1 nën pikën d), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.1140/2021 datë 22.05.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Bujar Muzaqi